

Mesazhe urimi nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dhe nga politikanë dhe personalitete të vendit drejtuar Kryepiskopit Anastas



Bordi i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, po ndjek me vëmendje dhe shqetësim ecurinë shëndetësore të Kryepeshkopit Anastas, i cili prej disa ditësh po përballet me një gjendje të rënduar të shëndetit të tij.

Ne, anëtarët e Bordit të Presidencës, Kryetari i KNFSH-së Mons. Gjergj Meta, anëtarët e Bordit të Presidencës, H. Bujar Spahiu (Kryetar i KNFSH-së 2023), H. Dede Edmond Brahimaj (Kryetar i KNFSH-së 2021) dhe Pastor Ergest Biti, me nderim dhe lutje të thella, i drejtohem Zotit për shërimin e shpejtë të Kryepiskopit Anastas, bashkëthemelues i KNFSH-së në vitin 2007, Kryetar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë në vitet 2018-2019 dhe 2024 dhe aktualisht anëtar i Bordit të Presidencës.

Ne lutemi me besim dhe përlulesi, që Zoti t'i dhurojë atij shëndet të plotë dhe forcë

për të vazhduar misionin e tij për paqen, harmoninë dhe dialogun ndërfetar. Kontributi dhe inspirimi i tij për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërfetar janë një mësim dhe udhërrëfyes për të gjithë ne.

O Zot, ne të lutemi që ta mbështesësh me çdo bekim dhe t'i dhurosh atij shumë vite të tjera shërbimi të bekuar, plot paqe dhe forcë shpirtërore, duke udhëhequr kështu një shembull të paqes dhe unitetit në shoqërinë tonë. Amin!

Me respekt,

Bordi i Presidencës

Burimi: KNFSH

Mesazhe në drejtim të Fortlumturisë së Tij Kryepiskopit Anastas janë bërë edhe nga politikanë:

“Të lutemi për shëndetin e Kryepeshkopit Anastas, me mirënjohjen për kontributin e paçmueshëm për ringritjen e Kishës Ortodokse Shqiptare”. ☩☩☩☩†

z. Niko Peleshi (Politikan)

“Me zotin përpara hirësi!

Të uroj bekimin e atij që i shërbeve!

Lutem për shëndetin tuaj!”

z. Pandeli Majko (Politikan)

“Lutemi për Kryepeshkopin Anastas ☩☩☩☩”

Genc Pollo (politikan)

[Radio “Ngjallja”](#)